



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

catalyst



Thirrje për organizata të shoqërisë civile (OShC) dhe aktivistë

TRAJNIM BAZIK PËR DIVERSIFIKIM DHE NGRITJE TË FONDEVE

Qëndrueshmëria financiare e organizatave të shoqërisë civile (OShC) është një ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet shoqëria civile në Kosovë, ku përkrahja më e madhe financiare për OShC vjen nga donatorët e huaj dhe fondet publike. Përkrahja si e tillë, e varur kryesisht nga dy burime të vetme të financimit, rrezikon qëndrueshmërinë e shoqërisë civile. Andaj, është e domosdoshme që të hulumtohen edhe mundësitë tjera të financimit dhe diversifikimit të burimeve përfshi forma të tjera të përkrahjes jo-financiare.

Llojllojshmëria e burimeve financiare dhe jo-financiare nënkupton identifikimin dhe mobilizimin e mbështetjes alternative financiare, si dhe kontributin përmes mbështetjes vullnetare nga qytetarët, sektori privat, ekspertët në Kosovë dhe diaspora. Kjo do të mundësonte që OShC-të jenë më të suksesshme në zbatimin e misionit të vet, të fuqizojnë lidhjen me konstituencën, si dhe të rrisin llogaridhënien dhe transparencën në raport me qytetarët.

Me qëllim që të kontribuojë në çështjen e qëndrueshmërisë së burimeve të organizatave të shoqërisë civile, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) përmes **Programit për Angazhim Qytetar (CEA)** të cilin e zbaton në partneritet me misionin e USAID në Kosovë, fton OShC-të, grupet joformale dhe aktivistët/et që operojnë kudo në Kosovë të aplikojnë për trajnimin bazik një-ditor për diversifikim dhe ngritje të fondeve.

Trajnimi bazik do të ofrohet nga grupi i trajnerëve dhe mentorëve profesionistë të trajnuar nga KCSF dhe Catalyst Balkans. I njëjti do të ofrojë informata kryesore mbi modelet e ndryshme të ngritjes së fondeve dhe do të jetë niveli i parë i ciklit të trajnimeve në qëndrueshmërinë financiare të OShC-ve. Si i tillë do të jetë obligativ në vazhdimin e ndjekjes së nivelit tjetër të trajnimit, atë të avancuar dhe mentorim të drejtpërdrejtë për ngritje të fondeve për organizatën. **Trajnimi i avancuar** do të trajtojë më thellësisht hartëzimin e burimeve nga komuniteti dhe punën konkrete në kornizën e mbledhjes së fondeve. **Mentorimi** do të përkrahë pjesëmarrësit e suksesshëm të këtyre trajnimeve në hartim të planeve e strategjive për diversifikim dhe ngritje të fondeve, si dhe/apo organizim të kampanjave të ndryshme për mbledhje të fondeve.

Trajnimi do të ofrohet në katër qytete të Kosovës, si në vijim:

- Prizren, më 26 mars 2024 (në gjuhë shqipe);
- Mitrovicë të Jugut, më 27 mars 2024 (në gjuhë shqipe);
- Prishtinë, më 28 mars 2024 (në gjuhë shqipe); dhe
- Graçanicë, më 30 mars 2024 (në gjuhë serbe);

Lokacionet se ku do të mbahen trajnimet do të përcaktohen në ndërkohë dhe informatat do të ju komunikohen pjesëmarrësve të përzgjedhur. Kandidatët, gjatë aplikimit duhet të përzgjedhin lokacionin dhe gjuhën e preferuar të trajnimit.

Çka përfitoni nga ky trajnim?

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është rritja e kapaciteteve të OShC-ve dhe të aktivistëve/eve të shoqërisë civile përmes informimit mbi modelet e ndryshme të ngritjes së fondeve, që do të siguronte një qëndrueshmëri më të madhe në punën e tyre, në komunitetet ku veprojnë.

Përmes një kurrikule të dizajnuar enkas për nevojat e OShC-ve në Kosovë, ju do të përfitoni njohuri mbi:

- Hulumtimin dhe identifikimin e burimeve të ndryshme për financimin e punës së organizatës tuaj apo të iniciativave tuaja;



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

catalyst



- Analizën e modeleve të ndryshme të ngritjes së fondeve, si: ngritja e fondeve përmes dhurimeve, pagesë të anëtarësisë, fushatave të targetuara individuale për ngritje të fondeve, partneriteteve ndër-sektoriale, kutive të donacioneve, fushatave digjitale, etj.;
- Ndërtimin e partneriteteve me biznese;
- Përgatitjen e fushatave dhe ngjarjeve për të mobilizuar fonde;
- Mjetet dhe format më adekuate për mbledhjen e fondeve nga individët dhe bizneset;
- Mobilizimin e diasporës në ngritje të fondeve;
- Përdorimin e teknologjisë për të mobilizuar fonde;

Pjesëmarrësit e trajnimit bazik do të ftohen automatikisht edhe në nivel të avancuar të trajnimit ku do të thellohen njohuritë e tyre për diversifikim dhe ngritje të fondeve, përderisa kandidatët e suksesshëm do të kenë mundësi të përfitojnë edhe mentorim të drejtpërdrejtë që do të ofrohet nga ekspertët e CEA.

Kush mund të aplikojë dhe cilat janë kriteret e aplikimit?

Të drejtë aplikimi kanë organizatat e shoqërisë civile, grupet joformale dhe aktivistët/et të cilat kanë interesim për të mësuar forma të reja të ngritjes së fondeve.

Secila OShC apo grup joformal duhet të propozojë 1 anëtar/e për të marrë pjesë në trajnim bazuar në përgjegjësitë e tyre brenda organizatës/grupit.

Kriteret e aplikimit:

- ✓ Të jetë Organizatë e Shoqërisë Civile (OSHC), e regjistruar në Kosovë, grup jo-formal apo aktivist/e i/e shoqërisë civile që vepron në Kosovë;
- ✓ Veprimtaria e OShC-së / grupit joformal / aktivistit/es të jetë kryesisht në nivel lokal dhe atë në komunitet;
- ✓ Të kenë të identifikuar si nevojë zhvillimin e kapaciteteve për forma alternative të ngritjes së fondeve për organizatën apo komunitetin në të cilin operojnë;
- ✓ Të kenë aktivitet në komunitet dhe/ose interesim për përfshirje të qytetarëve/eve në punën e organizatës / grupit joformal / aktivistit/es;
- ✓ Anëtari/ja e stafit të OShC që aplikon preferohet të jetë përgjegjës për ngritje të fondeve për organizatën.

Aplikantëve/aplikanteve të përzgjedhur/a do t'u kërkohet të jenë fizikisht të pranishëm në trajnim, me ç'rast do t'u mbulohen edhe shpenzimet e transportit.

KCSF inkurajon gjithëpërfshirje nga aspekti gjinor dhe përfaqësimit gjeografik nga të gjitha rajonet e Kosovës.

Si të aplikoni?

Aplikimi bëhet duke plotësuar formën elektronike në vegëzën në vijim:

<https://bit.ly/3SW2waT>

Vetëm aplikantët/et që përmbushin kriteret e përcaktuara do të kontaktohen për pjesëmarrje në trajnim, ku do të njoftohen edhe zyrtarisht për detajet logjistike. Në rast të pranimit të shumë aplikacioneve, KCSF do t'u jap përparësi atyre që kanë aplikuar të parët, me theks të veçantë sigurimit të barazisë gjinore dhe atyre që operojnë jashtë Prishtinës.

Afati i fundit për aplikim: 13 mars 2024.

Për informata tjera, ju lutem kontaktoni ekipin tonë në adresën elektronike enes.toska@kcsfoundation.org ose përmes telefonit në numrin: 038 600 634.